

L I G J
Nr.8267, datë 19.12.1997

PËR AGJENCINË SHQIPTARE TË GARANCISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj synon themelimin e Agjencisë Shqiptare të Garancisë, si një institucion financiar që krijohet për të lehtësuar e nxitur drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, nëpërmjet garancive që ajo ofron, investimet dhe veprimtaritë prodhuese në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe veprimtarinë e import-eksportit nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Agjencia Shqiptare e Garancisë, që më poshtë do të quhet "Agjencia", është person juridik i pavarur me seli në Republikën e Shqipërisë.

Ajo e ka selinë e saj në Tiranë.

Neni 3

Në kuptim të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Garancia" përfshin të drejtën e shpërblimit të dëmit sipas kushteve kontraktore, kundrejt humbjeve që rezultojnë në lidhje me transaksionet e kryera nga personat dhe të pranuara nga Agjencia.

"Transaksione të pranuara" janë veprimet juridike të kryera nga personat që përfshijnë ose kanë lidhje, tërësisht a pjesërisht, me kryerjen e një veprimtarie prodhuese në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që në zbatim të këtij ligji konsiderohen:

- Importimi i pajisjeve, makinerive, mjeteve të tjera të punës dhe lëndëve të para ose gjysmë të gatshme nga një subjekt me veprimtari tregtare në Shqipëri, me kusht që këto mallra të përdoren për veprimtari prodhuese në Republikën e Shqipërisë.

- Dhënia ose marrja me qira e mallrave nga një person, i cili e kryen veprimtarinë e tij në Republikën e Shqipërisë, për përdorimin e tyre në një veprimtari prodhuese në vend.

- Dhënia e kredive një personi, i cili e zhvillon veprimtarinë e tij në Republikën e Shqipërisë, me kusht që ato të përdoren për një veprimtari prodhuese në Republikën e Shqipërisë.

- Shitjet e mallrave që kryen një person, i cili zhvillon veprimtari në Republikën e Shqipërisë, me kusht që ato të përdoren për zhvillimin e një veprimtarie prodhuese në Republikën e Shqipërisë.

- Përpunimi, ndryshimi ose përfshirja e lëndëve të para në mallra që do të prodhohen në Republikën e Shqipërisë ose të mallrave gjysmë të gatshme që do të prodhohen në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht se nga cili vend e kanë origjinën e tyre apo importohen për në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Eksportimi nga territori i Republikës së Shqipërisë i mallrave të prodhuara apo të përpunuara pjesërisht në vend.

- Prodhimi ose përpunimi në Republikën e Shqipërisë i mallrave a pajisjeve që do të eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë.

- Furnizimi, instalimi, ndërtimi, vënia në përdorim, mirëmbajtja ose riparimi i mallrave a

pajisjeve të prodhuara tërësisht ose pjesërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë a të eksportuara nga Republika e Shqipërisë.

- Kryerja në Republikën e Shqipërisë ose në një vend të huaj e çfarëdolloj shërbimi ndaj një personi në lidhje me furnizimet, instalimet, ngritjen, vënien në përdorim, mirëmbajtjen a riparimin e mallrave dhe të pajisjeve të prodhuara tërësisht ose pjesërisht në Republikën e Shqipërisë dhe të eksportuara nga territori i Republikës së Shqipërisë.

"Ministër" është ministri i Financave.

"Person" janë gjithë personat juridikë e fizikë që kanë cilësinë e tregtarit nga legjislacioni, me të cilin ata janë regjistruar si të tillë dhe që janë palë me Agjencinë në kontratën e sigurimit.

"Përfaqësues" është përfaqësuesi ligjor i personave juridikë ose ai që zotëron një prokurë të posaçme për përfaqësimin e interesave të një personi juridik a fizik në kuptim të këtij ligji.

KREU II TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AGJENCISË

Neni 4

Për të realizuar qëllimin dhe funksionet e saj, Agjencia mundet:

1. Të ketë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme dhe ta shfrytëzojë atë për interesat e saj.
 2. Në lidhje me trasaksionet e pranuar, të hyjë në marrëveshje sigurimi ose risigurimi, dëmshpërblimi ose garancie ndaj çdo personi.
 3. Në lidhje me transaksionet e pranuar, të hyjë në marrëveshje që kanë efektin e dhënies së kredive ndaj çdo personi, ose të kryejë veprime për të financuar çdo person.
 4. Të marrë interesin e siguruar.
 5. Të hapë dhe të mbajë llogari në banka a institucione të tjera financiare në lekë dhe në valutë të huaj.
 6. Të hartojë dhe të publikojë informacionin e veprimtarisë së saj, si dhe të kryejë shërbime konsulente.
 7. Të propozojë për mënyrën e bashkimit, mbarimit, shpërndarjes apo likuidimit të saj.
 8. Të ketë të drejtë të bëjë investime dhe të marrë pjesë në transaksione të ndryshme për administrimin e financave të saj.
 9. Të pranojë nga çdo person financime, dhurata ose të përfitojë nga aktet e bamirësisë.
 10. Të veprojë si agjente për çdo person që e autorizon si të tillë ose të autorizojë persona të veçantë të veprojnë si agjentë në emër të saj.
 11. Të punësojë personel të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të saj, numri i të cilëve përcaktohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Paga e punonjësve të Agjencisë do të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
 12. Të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative, gjyqësore dhe juridiko-civile, për të ushtruar dhe mbrojtur interesat e veta sipas këtij ligji.
 13. Të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me ushtrimin e funksioneve të saj për të realizuar qëllimin.
- Agjencia mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj, si brenda, ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me miratim të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 5

Për të kryer funksionet, Agjencia duhet ta ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me parashikimet e këtij ligji, duke pasur parasysh që t'i ofrojë shërbimet e saj në mënyrë sa më të efektshme dhe ekonomike, si dhe të plotësojë detyrimet e Republikës së Shqipërisë që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, brenda fushës së objektit të veprimtarisë së saj.

Neni 6

Agjencia është subjekt i zbatimit të akteve të nxjerra nga ministri, të cilat duhet të kenë si

synim arritjen e objektivave të saj, kur ai e konsideron se ato janë të vlefshme dhe në dobi të interesit publik.

Ministri nuk mund të nxjerrë akte të detyrueshme për t'u zbatuar nga Agjencia, sipas parashikimit të paragrafit të parë të këtij neni, nëse ato:

a. kërkojnë futjen e Agjencisë në një marrëveshje të veçantë sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 4 të këtij ligji;

b. kërkojnë pranimin e përgjegjësisë për pagimin e ndonjë pretendimi ndaj Agjencisë në bazë të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 7

Agjencisë i lind e drejta të kërkojë rimbursimin e dëmeve të shkaktuara nga zbatimi i akteve të ministrit, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

Si dëm, në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, do të kuptojmë:

a. shkaktimin e një humbjeje nga zbatimi i aktit të ministrit ose aplikimin i një kostoje për një veprim që Agjencia nuk do ta kishte zbatuar po të mos ishte akti ose

b. aplikimin e një kostoje më të lartë nga Agjencia sesa kostoja që do të kishte paguar vetë Agjencia, nëse do të kishte vepruar vetë, pa pasur aktin e ministrit ose

c. mosrealizimin e të ardhurave që Agjencia do të kishte marrë, nëse nuk do të kishte vepruar në përputhje me aktin e ministrit.

KREU II ORGANET DREJTUESE TË AGJENCISË

Neni 8

Organet drejtuese të Agjencisë janë:

Këshilli Mbikëqyrës

Drejtori i përgjithshëm

Neni 9

Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë përbëhet nga nëntë anëtarë.

Këshilli Mbikëqyrës drejtohet nga kryetari i tij dhe përbëhet nga kryetari, drejtori i përgjithshëm, një anëtar të caktuar nga Banka e Shqipërisë, katër anëtarë nga ministri dhe një nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimeve. Dy anëtarë të tjerë zgjidhen si përfaqësues të shoqatave të investitorëve.

Kriteret, për përzgjedhjen e shoqatave të investitorëve dhe anëtarëve që propozohen nga to, caktohen nga Ministri. Këta anëtarë duhet të jenë specialistë të fushës së sigurimeve ose asaj bankare.

Neni 10

Kryetari dhe zëvendëskryetarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen nga anëtarët e këtij Këshilli.

Neni 11

Anëtarët e emëruar, sipas nenit 9 të këtij ligji, i ushtrojnë funksionet e tyre për një periudhë trevjeçare.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të shkarkohen përpara mbarimit të afatit nga organi që i ka emëruar. Një e drejtë e tillë ushtrohet pasi të jetë marrë mendimi paraprak i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë nuk janë të punësuar të saj.

Neni 12

Nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë personat të cilët:

- a. janë në gjykim ose kanë qenë gjykuar për paafësi paguese ose falimentim;
 - b. kanë pengesa ligjore për të qenë nëpunës civilë, sipas nenit 8 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 "Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë";
 - c. janë persona me sëmundje psikike ose zhvillim të metë mendor ose që nuk kanë zotësi për të vepruar dhe janë të deklaruar si të tillë nga gjykata kompetente;
 - ç. nuk kanë figurë të pastër morale dhe për këtë janë dënuar administrativisht ose penalisht;
 - d. më parë kanë abuzuar me pozitën e tyre zyrtare ose me pozitën si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë dhe vijimi i qëndrimit të tyre në këtë Këshill mund të jetë në dëm të interesave të Agjencisë;
- dh. ligji organik i vendit të punës e përjashton një anëtarësi të tillë.

Neni 13

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë zhvillohen, si rregull, në vendin ku ndodhet selia e saj. Këshilli do të mbledhet sa herë gjykohet e domosdoshme a e nevojshme për realizimin e funksioneve të tij. Ai i zhvillon mbledhjet në përputhje me rregullat e caktuara në këtë ligj dhe në aktet e tij për këtë qëllim.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës thërret mbledhjet e Këshillit me iniciativën e tij, me kërkesën e ministrit, të drejtorit të përgjithshëm ose të tre anëtarëve të Këshillit.

Neni 14

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës drejtohen nga kryetari i tij, kurse në mungesë të tij ose kur ai është liruar nga detyra dhe nuk është emëruar kryetari i ri, ato do të drejtohen nga zëvendëskryetari i këtij Këshilli. Nëse në mbledhje nuk është i pranishëm as kryetari dhe as zëvendësi i tij, dhe kur ky i fundit është liruar nga detyra dhe ende nuk është zgjedhur një person tjetër, anëtarët e pranishëm të këshillit kanë të drejtë të zgjedhin njërin prej tyre për drejtimin e mbledhjes me cilësinë e kryetarit të Këshillit, funksionet e të cilit si kryetar mbarojnë me zhvillimin e kësaj mbledhjeje.

Neni 15

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me votim të hapur dhe me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij pjesëmarrës në mbledhje. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtën e një vote. Në rastin e barazisë së votave, vota e kryetarit ose e personit që ka cilësinë e kryetarit në një mbledhje në bazë të dispozitave të këtij ligji, është vendimtare.

Neni 16

Kur një nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ka vetë ose anëtarët e familjes së tij interesa të drejtpërdrejta apo të tërthorta për një çështje që do ta shqyrtojë Këshilli Mbikëqyrës, ai është i detyruar të njoftojë për këtë Këshillin, çka pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes, dhe vetëm nëse kryetari i Këshillit Mbikëqyrës a ministri vendosin ndryshe nga sa më poshtë, ai nuk duhet:

- a) të jetë i pranishëm gjatë diskutimeve të anëtarëve të Këshillit në lidhje me çështjen,
- b) të marrë pjesë në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me këtë çështje.

Në rast se një nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk e zbaton parashikimin e paragrafit të parë të kësaj dispozite dhe më vonë del se ai ose anëtarët e familjes së tij kanë pasur lidhje të drejtpërdrejta a të tërthorta me një çështje që është diskutuar a vendosur në Këshillin Mbikëqyrës, ai shkarkohet menjëherë nga ky Këshill.

Për vlefshmërinë e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, kur shkelet kriteri i mësipërm, vendos vetë Këshilli posaçërisht, por në çdo rast, vendimi konsiderohet i pavlefshëm, kur ka qenë marrë me shumicën e një vote ose me vlerën e votës së kryetarit në rast barazimi.

Neni 17

Në rastet e veçanta për nga rëndësia dhe urgjenca e çështjes, për të cilat Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të mbledhet dot brenda kohës së kërkuar, ai ka të drejtë të nxjerrë akte të ndryshme të Agjencisë edhe pa bërë mbledhje, nëse ato janë nënshkruar nga më shumë se gjysma e anëtarëve të emëruar në ditën e nënshkrimit të aktit. Parashikimi për votën e kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, sipas paragrafit të fundit të nenit 15 të këtij ligji, nuk është i zbatueshëm në këtë rast. Një akt i tillë i miratuar sipas parashikimit të mësipërm, ka fuqinë e vendimeve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës në mbledhje.

Aktet e miratuara sipas parashikimit të këtij neni, hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga anëtarët e tij. Në rast se datat e nënshkrimit janë të ndryshme, ato hyjnë në fuqi në ditën që ka nënshkruar anëtari i fundit i këtij Këshilli.

Kur refuzohet nënshkrimi, qoftë edhe nga një anëtar, miratimi i aktit do të bëhet në mbledhjen më të parë të radhës të Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me rregullat e përgjithshme.

Neni 18

Në rast se sipas parashikimit të nenit 17 të këtij ligji janë nënshkruar më shumë se një akt, por që këto trajtojnë të njëjtin problem, ato do të konsiderohen si një akt i vetëm.

Neni 19

Asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të nënshkruajë akte sipas parashikimeve të nenit 17 të këtij ligji, në rast se ai vetë ose anëtarët e familjes së tij kanë interesa të drejtpërdrejta a të tërthorta me çështjen, për të cilën po del akti. Nëse anëtarët nuk i përmbahen parashikimit të mësipërm, ata shkarkohen menjëherë nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 20

Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të krijojë komisione për ta ndihmuar në lidhje me funksionet që ai do të ushtrojë.

Në rast se Këshilli Mbikëqyrës vendos për krijimin e komisioneve, njëri nga anëtarët e tij duhet të jetë detyrimisht drejtues i tyre.

Mbledhjet e komisioneve, të krijuara sipas parashikimeve të këtij neni, do të mbahen në vende dhe afate kohe të caktuara paraprakisht dhe do të zhvillohen në përputhje me procedurat e caktuara nga Këshilli Mbikëqyrës për këtë qëllim.

Neni 21

Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të nxjerrë akte të ndryshme sidomos:

a) për rregulloren e procedurave të tij, e cila përfshin njëkohësisht edhe të drejtën e delegimit të pushtetit të tij apo të kompetencave të tij komisioneve, si dhe për të përcaktuar quorumet e duhura për mbledhjet e këtyre komisioneve;

b) për përshkrimin e detyrave të nëpunësve dhe të punonjësve të Agjencisë;

c) për delegimin e të drejtës së drejtorit të përgjithshëm për kryerjen e ndonjë veprimtarie në emër të Këshillit Mbikëqyrës;

ç) për delegimin e të drejtave të parashikuara në shkronjën "a" të këtij neni, pavarësisht nga delegimi që mund t'u bëjë komisioneve, një ose më shumë nëpunësve të Agjencisë për t'i ushtruar ato së bashku apo veçmas;

d) për të kryer administrimin e veprimtarive të tij;

dh) miraton programet vjetore të punës, analizat për realizimin e tij, si dhe miraton bilancin e Agjencisë;

e) për miratimin e rezultateve të kontrollit të urdhëruara nga vetë Këshilli Mbikëqyrës, si dhe merr informacion për kontrollet e ushtruara nga drejtori i përgjithshëm dhe vendos për masat përkatëse.

Neni 22

Risqet që do të merren përsipër për t'u mbuluar nga Agjencia, kontrata e garancisë, si dhe procedurat për lidhjen e kontratës miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 23

Në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të nxjerra nga Këshilli Mbikëqyrës, ky i fundit përcakton termat dhe kushtet, mbi bazën e të cilave Agjencia ushtron veprimtarinë e saj.

Neni 24

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës kanë të drejtën e shpërblimit për pjesëmarrjen e tyre në këtë Këshill, që paguhet nga Agjencia në përputhje me aktet e nxjerra nga Këshilli Mbikëqyrës për këtë qëllim.

Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtën e caktimit të pagës së drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë.

Neni 25

Drejtori i përgjithshëm emërohet nga ministri për një periudhë trevjeçare me të drejtë riemërimi. Nuk mund të emërohet drejtor i përgjithshëm një person që plotëson një nga parashikimet e nenit 12 të këtij ligji.

Neni 26

Drejtori i përgjithshëm drejton dhe kontrollon gjithë veprimtarinë e Agjencisë dhe përgjigjet për të përpara Këshillit Mbikëqyrës, i cili mund t'i propozojë ministrit shkarkimin e tij, kur konstaton tejkallim ose shpërdorim të kompetencave të tij me pasoja për veprimtarinë e Agjencisë.

Neni 27

Drejtori i përgjithshëm përfaqëson Agjencinë në të gjitha marrëdhëniet me të tretët, me përjashtim të rasteve kur një e drejtë e tillë i është dhënë Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Drejtori i përgjithshëm emëron stafin punonjës të Agjencisë, në përputhje me kriteret e caktuara nga Këshilli Mbikëqyrës, sipas parashikimit të pikës 11 të nenit 4 të këtij ligji.

KREU IV KAPITALI, FINANCAT E AGJENCISË

Neni 28

Kapitali fillestar i autorizuar i Agjencisë është dhjetë milionë lekë. Mënyra e formimit dhe modalitetet e pagesës së tij caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave mund të vendosë për rritjen e këtij kapitali në çdo kohë që ai e gjykon të nevojshme.

Neni 29

Kapitali fillestar i Agjencisë është në pronësi të shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga Ministria e Financave. Ai nuk është i transferueshëm te të tretët tërësisht apo pjesërisht.

Neni 30

Këshilli i Ministrave mund të vendosë, brenda fondeve të caktuara nga buxheti i shtetit, në bazë të propozimeve të bëra nga ministri, që t'i japë fonde Agjencisë, të cilat janë të rikthyeshme në përputhje me kushtet dhe termat e vendosur nga vetë Këshilli i Ministrave.

Neni 31

Agjencia ka të drejtë që, me miratim të ministrit, të marrë hua ose kredi nga:

- a. bankat me seli në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj ose
- b. nëpërmjet emetimit dhe shitjes së letrave me vlerë, si dhe me anë të obligacioneve, të cilat duhet të vërtetojnë se Agjencia nuk ka detyrime financiare që mund të jenë me ose pa garancinë e Qeverisë Shqiptare.

Agjencia nuk mund të marrë hua ose kredi në mënyra të tjera, përveç atyre të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni.

Neni 32

Agjencia krijon fondet e saj rezervë ose provigjone, që të bëjnë të mundur të përballohen humbjet që mund të vijnë nga ushtrimi i veprimtarisë së saj.

Neni 33

Agjencisë mund t'i jepen subvencione nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet fondeve të parashikuara për këtë qëllim nga buxheti i shtetit, në ato raste kur për ndonjë transaksion të pranuar ka efektin:

- a. e dhënies ndaj çdo personi të sigurimit, risigurimit, dëmshpërblimit apo garancisë ose
- b. të dhënies së kredisë ndaj çdo personi ose dhënien e një garancie për t'i paguar para çdo personi.

Neni 34

Bilanci dhe llogaritë e Agjencisë mbahen në përputhje me rregullat e vendosura nga Këshilli Mbikëqyrës për këtë qëllim dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 35

Viti financiar i Agjencisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Neni 36

Llogaritë e Agjencisë kontrollohen nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët kanë kualifikimin e duhur për këtë qëllim. Ekspertët e parashikuar në këtë nen, propozohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe miratohen nga ministri. Detyrat dhe shpërblimi i ekspertëve kontabël të autorizuar përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 37

Agjencia, në kryerjen e veprimtarisë së saj, në të gjitha dokumentet drejtuar të tretëve, si dhe në publikimet e saj, do të mbajë detyrimsht emrin e saj të plotë "Agjencia Shqiptare e Garancisë", ose të shkurtuar "ASHG".

Neni 38

Mbarimi, shpërndarja dhe likuidimi i Agjencisë bëhen vetëm me ligj. Në çdo rast Qeveria Shqiptare do të marrë përsipër të gjitha detyrimet dhe pasivet e Agjencisë në datën në të cilën është bërë efektive mbarimi, shpërndarja ose likuidimi. Nga kjo datë të gjithë kreditorët kanë të drejtë të kërkojnë përmbushjen e detyrimeve të tyre nga Qeveria.

Neni 39

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 40

Ky ligj hyn në fuqi më datë 30.12.1997.

**Shpallur me dekretin nr.1979, datë 25 .12.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**